



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO  
KOMUNA E OBILIQIT  
OPŠTINA OBILIĆ - MUNICIPALITY OF OBILIC

KUVENDI KOMUNAL OBILIQ  
Skupština Opštine Obilić - Municipality Assembly Obiliq

**E K S T R A K T I P R O C E S V E R B A L I T**

Nga mbledhja e Kuvendit komunal të mbajtur me dt.28.01.2025, në orën 11:00, në sallën e Kuvendit komunal.

**Të pranishëm ishin këta anëtarë:** Enver Gashi (IQO), Shaip Paloja (IQO), Florije Jashari (IQO), Labinot Mirena (IQO), Vlora Mjekiqi Kabashi (IQO), Jeton Mjekiqi (IQO), Lulzim Preniqi (IQO), Fidan Ahmeti, (IQO), Nazlije Shala (IQO), Sami Ahmeti (LVV), Valon Svirca (LVV), Albana Shillova Shalaku (LVV), Ajet Berisha (LB), Valbonë Beka (LB), Bajram Hashani (LDK), Linda Sadiku Krasniqi, (LDK), Xhelal Krasniqi (AAK), Samire Berisha (PDK), Ratomir Ristic (SL) dhe Biljana Spasic(SL).

**Të pranishmit tjerë:** Ibush Mjekiqi, Nëkryetar i Komunës, drejtorët komunal, dhe përf. e KFOR-it

Mbledhjen e udhëhoqi Vlora Mjekiqi Kabashi, kryesuesee cila pasi konstatoisekakuorumfilloimbledhjen me këtë:

**R E N D D I T E**

1. Arsyetimi për mungesë
2. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e kaluar
3. Raporti i Punës së Kuvendit Komunal për periudhën Janar – Dhjetor 2024
4. Raporti financiar i shpenzimeve Janar-Dhjetor 2024
5. Shqyrtimi i kërkesave
6. Të ndryshme

**Kryesuesja** – I njoftoi të pranishmit me rendin e ditës, i cili u miratua me 18 vota për.

**Pika 1 e rendit të ditës**

**Mungoi:** Lendita Krasniqi

**Pika 2 e rendit të ditës**

Miratohen ekstrakti i procesverbalit nga mbledhja e kaluara me 16 vota për dhe 1 votë abstenim.

**Pika 3 e rendit të ditës**

**Kryesuesja** – Paraqiti Raportin e punës së Kuvendit Komunal për periudhën janar – dhjetor 2024, i cili është një raport i përgjithësuar për mbledhjet që janë mbajtë, vendimet që janë marrë, Rregulloret dhe 2 Komitetet.

**Enver Gashi** – Meqë, është mbledhja e parë e këtij viti, fillimisht anëtarëve të Kuvendit iu uroj punë të mbarë ndërsa, sa i përket raportit mendoj që është një raport i punës të Kuvendit dhe punës tonë, kështu që nuk kemi ndonjë vërejtje.



**Sami Ahmeti** – Mendoj se nuk do të duhej të ishte i përgjithshëm sepse të përgjithshmen e dijmë edhe ne, e dijmë sa seanca janë mbajtur dhe çka është marrë. Është dashtë me u përfshi të gjitha vendimet që i kemi marrë, ajo që është votue këtu dhe nuk kishte me u bë tepër. Sido që të jetë mua më duket më shumë raport arsyetues për pagat që i marrim se sa për punën që e kemi bërë dhe vendimet që i kemi nxjerrë të cilat edhe iu kanë shkaktue të mira qytetarëve. Mendoj se raporti do të duhej të ishte më i detajuar dhe e di që nuk votohet, por si rrjedhojë për mendimin tim nuk është raport, është më tepër arsyetim për këto pagat që janë marrë.

**Kryesuesja** - Z.Ahmeti, çdo vendim që është marrë është aprovue, ndërsa vendimet që i kemi shfuqizue, plotësue dhe ndryshue të gjitha gjenden në faqen zyrtare të Komunës. Unë e kam potencue edhe më heret se ne i raportojmë MAPL-së, çdo 3 muaj dhe neve na është dukë ndoshta një raport voluminoz me i përfshi edhe vendimet të cilat janë marrë, që nuk janë asgjë të fshehta sepse të gjitha janë të publikuara si vendimet e aprovuara ashtu edhe ato të shfuqizuara.

#### **Pika 4 e rendit të ditës**

**Kryesuesja** – Paraqiti Raportin financiar të shpenzimeve janar – dhjetor 2024.

**Enver Gashi** – Është një raport që e përgëzoj që ka ardhë me kohë dhe ne si grup nuk kemi ndonjë vërejtje.

**Sami Ahmeti** – Në fakt raporti do të duhej me ardhë me kohë dhe duhet me u shqyrtue nga anëtarët e Kuvendit komunal se është obligim. Ajo që mua më duket se po vazhdon forma e njejtë është pothuajse vendin kryesor po vazhdojnë me zënë pagat dhe medijet, ndërsa te investimet kapitale mbi 80 % e investimeve po vazhdon të shkoj vetëm te një projekt i cili deri më tani më shumë ka shkaktue kaos e prishje të rrugëve e shumë gjëra të tjera, se sa që po i vërehet fundi ose diçka në të mirë të qytetarëve. Ajo që deshta të theksoj është viti i tretë me radhë edhe pse është një shumë simbolike ne vazhdojmë mos me marrë raport sa i përket Kuvendit Komunal, shpenzimet e Kuvendit Komunal. Ne e dijmë se këtu, ka këshilltarë komunal që marrin mbushje telefonike çdo muaj nganjëherë për vete, e nganjëherë për familjarë të tyre dhe ne nuk marrim mbushje telefonike. Përveç, asaj dreka dhe darka që nuk vijmë asnjëherë, zhvillohen më shumë me Ekzekutiv se sa me anëtarët e Kuvendit Komunal, po ashtu edhe ekskurzione që më së paku bëhet punë atje. Për këtë arsye ju informoj se me mbarimin e kësaj seance unë do të bëjë kërkesë zyrtare për qasje në dokumente publike qysh na lejon ligji dhe çdo shpenzim që është bërë, e di që janë nga 9,000 euro, nuk është shumë e madhe por tendenca edhe te shumata e vogla kur keqpërdoren është tendencë e njejtë. Pra, unë do të bëjë kërkesë zyrtare dhe pres përgjegjen, në të kundërtën na duhet me i marrë masat tjera.

**Kryesuesja** – Sa i përket shpenzimeve, raportit financiar të Kuvendit Komunal që thatë dreka dhe darka të gjithë ftohen në mënyrë të hapur dhe transparente dhe gjithçka shkon live transmetohet dhe ftohen pas mbledhjes si ka qenë gjithmonë prej se është themelue ndoshta ky Kuvend, prej paslufte e këndeje. Sa i përket mbushjeve telefonike, të gjithë anëtarëve të Kuvendit, nuk është hera e parë iu ka kërkuar numri që me iu dërgue mbushje elektronike secilit pavarësisht ata të cilët nuk kanë dashtë me ndryshue numrin sepse është numër partiak, që edhe për këtë ka të dhëna. Sa i përket vizitave jashtë vendit, është një plan i punës ku po ashtu, edhe ju keni qenë anëtarë i këtij Komisioni që është formue Komisioni nga ky Kuvend dhe janë nënshkrimet. Gjithsesi është e drejta juaj që kisha dashtë edhe unë të kërkonim qasje në dokumente sepse është mirë gjithçka të shihet.

**Ajet Berisha**– Unë kam 2 pyetje te raporti i të hyrave është pasqyrue janar-shtator, janë 90.42 % realizimi i të hyrave dhe pyetja ime është a është deri në shtator apo deri në dhjetor.

**Nënkryetari** – Përgjegjet deri në dhjetor.

**Ajet Berisha** – E kam edhe një pyetje te investimet kapitale, ndërtimi i parkingut rruga “Adem Jashari” janë 50,000 euro, realizimi qind për qind ku është realizue ky projekt sepse në këtë rrugë jam dhe nuk e di.

**Nënkryetari**– Përgjegjet se projekti është mendue në vitin e kaluar të filloj, është ndërtimi te shkolla e vjetër, por ju e dini se në vitin e kaluar mbi 1 milion e 600 mijë euro janë marrë nga përmbaruesi, kështu që ka dalë si shpenzim përndryshe nuk ka fillue.



**Ajet Berisha** – Nuk duhet të figuroj si projekt i kryer sepse po delë një lloj mashtrimi që po bëhet në raport dhe është mirë me përmirësue.

**Pika 5 e rendit të ditës**

**Kryesuesja**– Paraqiti kërkesën nga Ministria e financave, për plotësim ndryshimin e vendimit për ndarjen e mjeteve buxhetore në shumën prej 2,000 euro, për Komisionin Komunal të zgjedhjeve lidhur me përgatitjet për Zgjedhjet e Përgjithshme Parlamentare të cilat do të mbahen me dt.09.02.2025.

Të nderuar anëtarë të Kuvendit, ne e kemi marrëveshjen e bashkëpunimit në mes të Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve dhe Komunës së Obiliqit, që do ti bashkëpunimet vendimit dhe kemi nga Drejtoria e financave nënprogramin se mjetet do të merren nga kategoria mallra dhe shërbime

Anëtarët e Kuvendit Komunal me 18 vota për dhe 2 vota abstenim morën Vendim për plotësim ndryshimin e vendimit nr. 01-060-01-36671-24, të dt.29.11.2024 për ndarjen e mjeteve buxhetore në shumën prej 2,000 euro, për Komisionin Komunal të Zgjedhjeve, lidhur me përgatitjet për Zgjedhjet e Përgjithshme Parlamentare të cilat do të mbahen me dt.09.02.2025.

**Kryesuesja**– Paraqiti kërkesën nga KBI-ja, që është pika 6 e rekomandimeve të KPF-së, të dt.20.12.2024, ku i rekomandohet Drejtorisë së financave për mundësinë e transferimit të mjeteve financiare, nga Korporata Energetike e Kosovës (KEK), pas zhvendosjes së Xhamisë në fshatin Siboc.

**Enver Gashi** – Kryesuese, ju veç e sqaruar komplet çështjen. Ajo xhami është ndërtuar nga komuniteti dhe toka ku është xhamia është e Komunës, ndërsa edhe Bashkësia Islame ka qenë e involvuar në investimin e xhamisë dhe kërkon që ato mjete të ndërtimit të shkojnë në BIK. Ne jemi për atë që ato mjete të shkojnë drejtë, pse me ardhë te ne e me ua krye edhe një herë, edhe me ligj jam konsultuar sepse ata e kanë ndërtue.

**Sami Ahmeti** – Që ata ti marrin ato mjete jemi defenitivisht dakord, por më duket pak jonormale sepse ju nxjerrim punë të reja atyre me shkue me bë marrëveshje me KEK, që ka qenë dashtë me shkue qysh kanë ardhë përmes Komunës me dërgue te ata. Sido që të jetë çfarëdo që është në të mirë të tyre nëse, kjo është forma më e lehtë dhe është rruga më e shkurtë kështu, jemi dakord edhe pse unë mendoj se është dashtë me u nda ato mjete prej shumës së përgjithshme nga Komuna. Sido që të jetë nëse, ata janë dakord dhe iu përshtatet jemi dakord, nuk prish punë se nga kush dërgohen sepse mjetet janë të shtetit këto dhe ato.

**Ajet Berisha**– E para, kërkoj sqarim se ju thatë se është në kuadër të rekomandimeve dhe te rekomandimet i kemi 5 pika, që këtë unë nuk e shohë fare, do të thotë nuk është në kuadër të rekomandimeve të këtij muaji dhe mendova se mua mos më ka ardhë gabim.

**Kryesuesja** – Sqaron se është pika 6 e rekomandimit që e potencova të dt.20.12.2024 dhe nuk është në kuadër të rekomandimeve të këtij muaji.

**Ajet Berisha** – Pjesa tjetër, qysh është më së miri ligjërishit dhe më praktike le të realizohet, që mos të bëhen vonesa dhe nuk kam ndonjë vërejtje.

**Shaip Paloja** – Me sa e kuptova, ne nëse nxjerrim një vendim të tillë vijmë në kundërshtim me ligjin sepse aty po thuhet se është bërë një ndërtim, në pronën komunale pa leje ndërtimi. Unë nuk di me çfarë leje, apo qysh e kanë ndërtue atë xhami aty në pronën komunale dhe a kanë ndonjë vendim të Komunës. Tash, nuk di qysh mund të paguhet një pronë kur pronar është Komuna.

**Nënkryetari** – Sa i përket çështjes së lejes, kjo është ndërtue në vitin 2000 dhe prona nuk iu paguhet z.Shaip, prona i paguhet Komunës e parcela paguhet në Komunë. Vlerësimin që e ka bërë Komisioni për vlerësimin e objekteve të banimit, fetare e të tjerave, e ka bërë KEK-u, dhe është llogaria e saktë se sa do të paguhet si objekt atje, është e ndarë. Mënyra më e lehtë dhe më e mirë e pagesës që të shkoj direkt në Bashkësinë Islame, pastaj ata të investojnë në një lokalitet tjetër ku është edhe është bërë përrurimi, ose fillimi i ndërtimit të xhamisë në fshatin Hade e re, respektivisht në Shkabaj, kështu që ata fillojnë me ndërtue dhe kjo është mënyra më e lehtë. Ndërsa, sa i përket pronës prona si pronë aq sa është paguhet sipas Ligjit të shpronësimit edhe për Komunën.

**Arben Berisha** – Ato që i tha Nënkryetari ashtu është dhe vlerësimi është bërë ndaras për objektin dhe për parcelën. Parcela është e ndërtuar në vitet e hershme dikund në vitet e 70-ta, kështu që është objekt i



komunitetit dhe komuniteti vetë e ka ndërtue ndërsa, ato mjete tash po i kërkon me ndërtue xhaminë në Haden e Re. Ne e kemi planin rregullativ dhe e parashehë edhe harta zonale, kështu që duhet të transferohet të ndërtohet xhamia për shkak të komunitetit. Do të thotë nuk ka paqartësi dhe gjithçka është e sqaruar.

**Shaip Paloja** – Unë e kam një pyetje për drejtorin nëse, një person privat ka ndërtue në pronën komunale dhe KEK-u, ia konfiskon atë pasuri ose është interes, a i paguhet pjesa e materialit që është në pronën komunale, kur është fjala për personin privat.

**Nënkryetari** – Ne kemi pasë rast sepse procesi i shpronësimit ka fillue prej vitit 2004 dhe jemi në dijeni. Po ashtu, ka pasë raste edhe në Hade dhe në Shipitullë kur kanë pasë prona, ose shtëpi të ndërtuara në vitet 60-të, ose 70-të, mirëpo prona komunale nuk iu paguhet, por iu ka pague vetëm objekti si objekt. Unë flas me përgjegjësi të plotë sepse vijë nga ajo zonë dhe ju keni informata se ka njerëz që kanë premtue edhe pronën me ia bartë përmes Kuvendit. Z.Ajet Berisha e din saktë se me mua është përballë me një palë bashkarisht që kërkonte me bartë pronën, por që nuk bëhet ajo punë sepse dihet se pronat në Kosovë kanë pasë dhe ende kanë probleme në bartje.

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit Komunal me 20 vota për e aprovuan kërkesën për transferimin e mjeteve financiare, nga Korporata Energetike e Kosovës (KEK), në xhirollogarinë e Këshillit të Bashkësisë Islame – Dega në Obiliq sa i përket objektit ndërtimor të Xhamisë në fshatin Siboc.

**Kryesuesja**– Sigurisht e dini edhe ju se i kam parë emailat që keni qenë të përfshirë edhe ju anëtarët e Kuvendit, ku dje ka ardhë një peticion pa protokol vetëm me kopje të letërnjoftimit dhe numri i telefonit. Një grup qytetarësh organizon këtë peticion për rregullimin e transportit të udhëtarëve me autobus në Komunën e Obiliqit dhe të merret si model ashtu si e ka bërë Komuna e Prishtinës. Paraprakisht para se të hap debat, propozoj që ky peticion duhet fillimisht të shqyrtohet në Drejtorinë përkatëse.

**Enver Gashi** – Edhe unë deshta të them se ky peticion duhet ti dërgohet DSHPE-së, të shqyrtohet mirë edhe nga Drejtoria e financave dhe të shihen mundësitë nëse, veç janë mundësitë pse jo të sjellet në Kuvend dhe Kuvendi e jepë kontributin e vetë.

**Sami Ahmeti** – Unë edhe kështu pata me thënë se kërkesa është e drejtuar nga njëra anë, por nuk e kemi anën tjetër e cila na jepë udhëzimet se nga, qysh dhe si bëhet kjo marrëveshje. Sido që të jetë e konsideroj se është një çështje shumë e mirë për qytetarët në rast se bëhet sipas kërkesës që është bërë. Ne jemi plotësisht dakord, që kjo kërkesë të realizohet, mirëpo jo që të bëhen shkelje ligjore sepse tani po zvarriten nëpër Ministri dhe po vonohet puna. Fillimisht le të vjen Drejtoria përkatëse me rekomandim me të gjitha matjet, qoftë edhe ato buxhetore pastaj normal që ne jemi dakord që të plotësohet kjo kërkesë që është bërë në këtë peticion.

**Ajet Berisha** – E ka trajtue Komiteti dhe nuk na kanë ardhë përgjegjet, që unë nuk e di për çka është ky peticion.

**Kryesuesja** - Kërkesa që është trajtue në Komitet për Politikë dhe Financa, nuk ka të bëjë fare me peticion. Peticioni ka ardhë dje në emailat e të gjithë anëtarëve të Kuvendit, e keni në email dhe është dëshmi. Ky peticion ka ardhë nga Diellza Aliu në emailat zyrtare.

**Ajet Berisha** – Sa i përket këtij peticioni sinqerisht asgjë nuk po kuptoj, gjithë këtë punë me bë, gjithë këto nënshkrime dhe çka kanë kërkue nuk e di, as nuk ka sqarim me bë sikurse Prishtina, që e ka bë unë nuk di qysh e ka bë Prishtina. Në thelb këtu, është një peticion që shihet se është bërë një angazhim me marrë nënshkrime dhe nuk kuptohet për cilin qëllim është bërë ky peticion. Pra, cili është qëllimi i peticionit, me rregullue transportin, që ne mirë ose keq transporti në një formë është i rregulluar. Këta, është dashtë me thënë nuk është mirë për këtë ose synojmë ose kërkesa jonë është me bë kështu, e këta nuk kanë kërkue por vetëm kanë thënë me rregullue dhe çka me rregullue nuk e di. Nëse, ju e dini dhe e keni kuptue unë kërkoj falje që nuk po e kuptoj, por nga ky peticion me gjithë këtë nënshkrim asgjë nuk kam kuptuar se çka kanë kërkuar.

**Naim Miftari** – Drejtoria e shërbimeve publike e ka pranuar kërkesën dhe rekomandimet nga Komiteti për Politikë dhe Financa. Kësaj kërkesë nuk mund ti jepet përgjegje ad-hoc, aty për aty pasi që e don një



studim dhe Drejtoria jonë do ta formoj një Komision, i cili do ta analizoj situatën në terren për të gjithë operatorët transportues, të cilët kryejnë shërbime në territorin e Komunës së Obiliqit dhe do të përpiloj raport me shkrim në fund të punës. Si modalitet mund ta marrim Komunën e Prishtinës, por mund të shikojmë se çka mund të bëjmë më mirë. Peticioni është mbështetje e kërkesës nga qytetarët.

**Ajet Berisha** – Këtu, nuk po kuptohemi kështu që është mirë këtyre të peticionit me iu thënë sqaroni çka po doni, çka ka kërkuar këtu qytetari.

**Kryesuesja** – Peticioni te Drejtoritë nuk ka ardhë dhe ajo kërkesë që është trajtue në Komitet për Politikë dhe Financa, është diçka tjetër, është rekomandue te ju që me ardhë me një përgjegje në Kuvend, qoftë në këtë apo në mbledhjen e radhës. Peticioni sipas Statutit të Komunës së Obiliqit, neni 33 Kuvendi i Komunës nuk do të ketë poarsysh asnjë peticion që ka të bëjë me çështjet jashtë përgjegjësive dhe kompetencave të Komunës. Kjo, është përgjegjësi e Komunës, çdo peticion duhet të përmbaj emrin, mbiemrin dhe adresën e organizatorit dhe emrat e adresat e personave që nënshkruajnë. Lënda e peticionit duhet të shenohet qartë në çdo faqe të peticionit. Nuk është shumë e qartë, por meqë ka ardhë në emailat zyrtare janë nënshkrimet patjetër që mua, më është dashtë me lexue. Unë nuk e njohë këtë vajzën që e ka dërgue në secilën email të anëtarëve të Kuvendit dhe unë e paraqita para juve. Edhe pse nuk është e protokoluuar mendoj se është mirë ti rekomandojmë Drejtorisë përkatëse, e Drejtoria të kontaktoj me njerëzit dhe në mënyrë zyrtare të vjen ashtu qysh duhet me ardhë një peticion me numër protokoli.

**Fidan Ahmeti** – Unë aq sa e kam kuptue qysh është Prishtina duke operue me trafikun urban me këtë pjesën, këta po kërkojnë të paguhen sipas kilometrave për shembull në disa fshatra që shkojnë një herë, ose asnjë herë linjat e autobusit me bë 5 herë në ditë dhe ata nuk e kanë problem a kanë udhëtarë apo nuk kanë të subvencionohen prej Komunës, sipas kilometrave. Kjo është arsyeja, por ne duhet të shikojmë qysh kemi mundësi me i subvencionue sepse vlera është mjaft e madhe që ndoshta është e pamundur e ndoshta edhe e mundur, por Drejtoria përkatëse le të vjen me një plan komplet dhe të shikojmë se a kemi mundësi, apo nuk kemi mundësi.

**Kryesuesja** – Ne duhet ti rekomandojmë DSHPE-së, që të kontaktoj me njerëzit se peticioni duhet të ketë një numër, një sqarim në të cilin bazohet dhe ka afat 3 muaj peticioni të shqyrtohet dhe të vjen i kompletuar në Kuvendin Komunal.

Anëtarët e Kuvendit Komunal unanimitisht u pajtuan që peticioni ti rekomandohet DSHPE-së, dhe të vjen i kompletuar për shqyrtim në seancën e Kuvendit Komunal.

#### **Pika 6 e rendit të ditës**

**Kryesuesja** – Ne kemi pranuar një përgjegje nga Drejtoria e Arsimit për pyetjen e z.Sami Ahmeti të paraqitur në Komitetin për Politikë dhe Financa. Që nga fillimi i vitit shkollor 2024-2025 DKA-ja, është kujdesur që sistemi i ngrohjeve të jetë në gjendjen e duhur për përdorim. Duke realizuar kështu kushtet e nevojshme mësimore dhe kushtet e ngrohjes, ashtu që gjysëmvetori i dytë ka filluar sipas planit vjetor dhe pa asnjë ndërprerje mësimore siç jeni në dijeni edhe ju bazuar në vijueshmërinë e fëmijëve tuaj në procesin mësimor. Edhe përkundër vështirësive në kontratat e tenderuara dhe problemet dhe në organet shqyrtuese të Prokurimit publik, ne si DKA në muajt e verës i kemi tenderuar projektet e furnizimit me dru, kemi arritur që përmes rezervave dhe nga viti paraprak si dhe furnizimin me thëngjill nga KEK-u. DKA në fundvit ka bërë shkresat e duhura te korporata bazuar në memorandumun e mirëkuptimit në mes Kryetarit dhe KEK-ut, të kordinojmë punët që gjendja e ngrohjes të jetë në nivelin e duhur dhe dëshmitë i keni në secilën shkollë, në secilin Këshill të prindërve, me të cilin kemi bashkëpunuar. Tashmë, ju mund të keni qasje në të gjitha objektet mësimore dhe ta vërtetoni se ngrohja është në nivelin e duhur dhe plotëson kërkesat e sezonit dimëror. Me 18 dhe 19 janar ne kemi furnizuar të gjitha objektet arsimore me dru sipas kontratës që tashmë e kemi nënshkruar. Pra, as nuk kemi pasë ndërprerje, as nuk do të ketë hapësirë për shqetësim sepse gjithçka është mirë e menaxhuar.

**Sami Ahmeti** – Realisht nga fundi veç e morëm përgjegjen sepse është dashtë me thënë qysh në fillim se kemi problem me OSHP-në, i kemi zhvillue procedurat por nuk kemi arritë me i sigurue. Mirëpo, që ka



pasë pengesa ka pasë dhe mirë që është rregullue, na gëzon fakti sepse fëmijët janë të të gjithëve, kështu që në rregullë, shpresojmë të jetë kështu.

**Ajet Berisha** – Unë veç me një element në përgjegje nuk pajtohem. Unë nuk e di për të gjitha shkollat, por e di që shkolla e mesme ka pasë problem dhe këtu, po thotë se nuk kemi pasë problem. E vërteta është se ka pasë probleme në shkollën “Hasan Prishtina” dhe nuk është turp me pranue realitetin, turp është me u shmang prej tij dhe me raportue rrejshëm. Në këtë rast për mua ka raportue rrejshëm kush e ka shkruar këtë shkresë sepse problem kanë pasë me ngrohje dhe e kemi këtu edhe profesoreshën që është aty. Nuk është turp me thënë kemi pasë problem me kalldaj, ose kemi pasë mungesë me OSHP-në, do të thotë të raportohet ashtu qysh është situata dhe pse kemi nevojë me iu shmangë kur secili prej neve i kemi fëmijët aty dhe e dijmë qysh është gjendja. Realiteti është se ka pasë probleme me ngrohje, por ka kalue që është shumë mirë dhe nuk guxojmë që për çdo vit gati nëpër shkolla ky problem po na paraqitet sidomos në shkollën e mesme ndërsa, ato që e kanë ngrohjen me pelet më mirë po e kalojnë. Mendoj se ne duhet me i marrë disa vendime me i ndërru këto kalldaja me i bë me pelet, ose me rrymë sepse po ka telashe erdhën drutë, nuk erdhën drutë ndoshta pa fajin e Komunës, por realiteti është se aty fëmijët ose po i mbajnë nga gjysmë ore, ose po i lëshojnë krejtë, do të thotë raporto ashtu qysh është. Ne nuk po themi çka qenka bërë, por raportimi të jetë korrekt që na ndihmon me zgjidhë problemin.

**Labinot Mirena** – Krejtë këto faje që janë nëpër shkolla është një adresë Qeveria e Kosovës, te nxemja qëndrore sepse po te kishin subvencionu nxemjen qëndrore tashmë, nuk kishim pasë nevojë as me ndez kalldaja, as asgjë, e kishim lëshue nxemjen qëndrore dhe nuk na kishin ardhë fakturat e rrymës aq shtrenjtë qysh po na vijnë. Mirëpo, besojmë dhe shpresojmë se kjo çështje pas 9 shkurtit nuk do të ketë telashe.

**Sami Ahmeti** – Me datën 15 janar 2025 Qeveria e Republikës së Kosovës, respektivisht Policia e Republikës së Kosovës, ka bastisur dhe mbyllur rreth 30 objekte të strukturave paralele sërbe të cilat menaxhoheshin nga Lista sërbe. Në mesin e këtyre objekteve është edhe objekti i Komunës paralele në Plemetin dhe ajo që dua të theksoj është se përfaqësues i kësaj Komune paralele ishte z.Slavisa Jakovljevic, i cili nga ky Kuvend dhe nga Kryetari i Komunës, është zgjedhë Nënkryetar i Komunës. Kjo, për neve është skandaloze që një person i cili punon për dhe me strukturat paralele të kordinuara nga Lista sërbe respektivisht nga Serbia dhe Rusia, është edhe Nënkryetar i Komunës tonë që paguhet me paratë e taksapaguesve të Republikës së Kosovës. Përveç kësaj z.Slavisa Jakovljevic, është edhe drejtor në ndërrmarjen ilegale “Pastrimi” e quajtur me emrin shërbime publike komunale. Kjo ndërrmarje merret me pastrimin e fshatrave sërbe ndërsa, pagat i marrin nga Qeveria e Serbisë. Në kuadër të kësaj ndërrmarje dyshohet se zhvillohen edhe aktivitete ilegale. Duke u nisë nga kjo që e thashë më lartë kërkoj që ky person të shkarkohet sot në këtë seancë sepse nuk mundet një person me marrë pagë nga Republika e Kosovës dhe me u komandue nga Serbia, Andaj, unë kërkoj nga kryesuesja që ta hudhë në votim këtë çështje dhe këtë person ta shkarkojmë sot, e nëse jo atëherë unë i kam arsyet e plota me mendue se diçka nuk është në rregullë, a jemi në anën e duhur apo me Serbi.

**Kryesuesja** – I nderuari z.Ahmeti, ne nuk mundemi as me emëru as me shkarkue dikend aty për aty sepse edhe vetë keni qenë kundër në shumë raste të tilla pa pasë dëshmi dhe pa i vërtetue këto. Unë jam pro dhe ju të gjithë jeni pro që nëse, këto janë të vërteta mund ti sjellni të gjitha të dhënat në mbledhjen e radhës dhe të shohim si ia bëjmë. Mendoj se kjo punë jo vetëm për atë, por as për mua këtu konkretisht nëse dikush thotë se kryesuesja bën veprime ilegale nuk mund të merret diçka aty për aty pa pasë dëshmi. Pra, të sjellen dëshmitë dhe ne punojmë sipas ligjit, jo vetëm unë por të gjithë.

**Ajet Berisha** – Mendoj se z.Sami, të vetmen gjë që është dashtë me bë është që këto argumente të na i dërgoj edhe neve në email, ose me i deponue te ju përndryshe ky informatën e ka se atje është duke punue. Do të thotë ky informatat i ka shtetërore se veprimin e kanë bërë institucionet shtetërore dhe në rast se është e vërtetë është mirë me komunikue, me i kërkuë këto dëshmi në mënyrë që të inicohet procedura në mbledhjen e radhës.



**Kryesuesja** – Këto, të dhëna është dashtë me u drejtue ashtu qysh ka ardhë peticioni në email të secilit edhe këto të dhëna kanë mund të na vijnë, pastaj i kishim shqyrtue dhe thashë se nuk jam dhe nuk do të jem aspak kundër ligjit.

**Sami Ahmeti** – Këto, të dhëna janë vetëm 50 %-i, i atyre çka mund ti flas publikisht dhe këto janë jo vetëm të vërteta, por 500 % të vërteta dhe këto i kanë ditë qytetarët që vazhdimisht neve, na kanë thënë se po shkojnë po marrin vërtetime te z.Slavisa, në objektin paralel në Plemetin. Mirëpo, këtë gjë e keni ditë edhe ju, por diqysh është e frikshme sikurse dikush edhe po bashkëpunon me të.

**Kryesuesja** – Z.Ahmeti, kisha dashtë mos me na përfshi sepse ne nuk i kemi këto të dhëna dhe është mirë mos me i përfshi të tjerët. Sido që të jetë ne nuk kemi asnjë dëshmi as nga ju, as nga askush dhe mund të flas me përgjegjësi të plotë për veten time në radhë të parë.

**Sami Ahmeti** – Me fjalën ju dua ta përmirësoj veten, me fjalën ju e nënkuptoj Ekzekutivin sepse ne si anëtarë të Kuvendit Komunal, çka po na servohet po bëjmë, por kjo që po e them është e sigurtë. Unë do të ju ofroj të gjitha informacionet dhe ju lutem shkruani 2 rreshta kërkesë për Polocinë e Kosovës dhe shihni ç çka ju shkruan.

**Nënkryetari** – Nuk mund të adresohet në Ekzekutiv sepse unë personalisht nuk kam informacione. Nëse, vjen ndonjë vendim gjygjësor që z.Ibush Mjekiqi apo kushdo qoftë ka bërë këtë atëherë merret vendim, në të kundërtën këto fjali paushalle unë nuk mund ti pranoj. Nuk mund të adresohesh në emër të Ekzekutivit sepse unë nuk bashkëpunoj sikurse pjesa tjetër me askend. Bashkëpunoj vetëm në kuadër të ligjit, prandaj është shumë i rëndë ky fjalim i mbajtur nga ana jote. Në anën tjetër për dreka e darka ne nuk kemi paguar as 5,000 euro, as 350,000 euro, dreka dhe darka janë paguar aq sa keni marrë pjesë edhe në ekskurzione të cilat i kemi pasë punëtori pune. Prandaj, të lutem tërhiqe fjalën sepse Ekzekutivi nuk është bashkëpunues me organet paralele të asnjë institucioni.

**Sami Ahmeti** – Fillimisht sa i përket drekave dhe darkave është mirë me folë kur është pika e rendit të ditës sepse mos ke qenë i dehur se 350,000 euro, nuk e përmenda.

Mbledhja përfundoi në ora 11:57'

Bashk.prof.për punë të KK

Azize Zeneli







REPUBLICA E KOSOVËS  
REPUBLICA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO  
KOMUNA E OBILIQIT  
OPŠTINA OBILIĆ - MUNICIPALITY OF OBILIC

KUVENDI KOMUNAL OBILIQ  
Skupština Opštine Obilić - Municipality Assembly Obiliq

IZVOD IZ ZAPISNIKA

Sa sednice Skupštine opštine održane 28.01.2025.godine u 11:00 časova, u sali Skupštine opštine.

**Prisutni članovi:** Enver Gashi (IQO), Shaip Paloja (IQO), Florije Jashari (IQO), Labinot Mirena (IQO), Vlora Mjekiqi Kabashi (IQO), Jeton Mjekiqi (IQO), Lulzim Preniqi (IQO), Fidan Ahmeti, (IQO), Nazlije Shala (IQO), Sami Ahmeti (LVV), Valon Svirca (LVV), Albana Shillova Shalaku (LVV), Ajet Berisha (LB), Valbonë Beka (LB), Bajram Hashani (LDK), Linda Sadiku Krasniqi, (LDK), Xhelal Krasniqi (AAK), Samire Berisha (PDK), Ratomir Ristić (SL) i Biljana Spasić (SL).

**Ostali prisutni:** Ibush Mjekiqi, zamenik gradonačelnika opštine, opštinski direktori, KFOR.

Sastanak je vodila Vlora Mjekiqi Kabashi, predsedavajuća koja nakon što je konstatovala da postoji kvorum, započela sastanak sa sledećim:

DNEVNIM REDOM

1. Opravdanje za odsustvo
2. Usvajanje izvoda iz zapisnika sa prethodnog sastanka
3. Izveštaj o radu Skupštine opštine za period januar – decembar 2024. godine
4. Finansijski izveštaj rashoda januar-decembar 2024. godine
5. Razmatranje zahteva
6. Razno

**Presedavajuća** - upoznala je prisutne sa dnevnim redom koji je usvojen sa 18 glasova za.

**Tačka 1. dnevnog reda**

**Odsutna:** Lendita Krasniqi

**Tačka 2. dnevnog reda**

Izvod iz zapisnika sa prethodne sednice usvojen je sa 16 glasova za i 1 uzdržanim glasom.

**Tačka 3. dnevnog reda**

**Presedavajuća** – Predstavila je izveštaj o radu Skupštine opštine za period januar – decembar 2024. godine, koji predstavlja opšti izveštaj o održanim sednicama, donetim odlukama, pravilnicima i 2 komisijama.

**Enver Gashi** – Pošto je ovo prvi sastanak ove godine, pre svega želim članovima Skupštine uspešan rad, što se tiče izveštaja, mislim da je to izveštaj o radu Skupštine i našem radu, tako da mi nemamo nikakve primedbe.



**Sami Ahmeti** – Mislim da ne bi trebalo da bude uopšteni izveštaj, jer znamo da su sednice održavane i šta je doneto. Neophodno je uključiti sve odluke koje smo doneli, ono što je ovde izglasano i nije bilo preterivanja. U svakom slučaju, čini mi se da je izveštaj više opravdanje za plate koje primamo nego za posao kojeg smo uradili i odluke koje smo doneli, a koje su donete u korist građana. Mislim da izveštaj treba da bude detaljniji i znam da se ne glasa, ali kao rezultat toga, po mom mišljenju, to nije izveštaj, to je opravdanje za plate koje smo dobili.

**Presedavajuća** - Gospodine Ahmeti, svaka doneta odluka je odobrena, a odluke koje smo poništili, dopunili i promenili se nalaze na zvaničnom sajtu opštine. Već sam naglasio da mi izveštavamo MALU svaka 3 meseca i čini nam se da je to verovatno obiman izveštaj koji uključuje donete odluke koje nisu ništa tajna jer se sve objavljuju kao usvojene odluke, ali i poništene.

#### **Tačka 4. dnevnog reda**

**Presedavajuća** – Predstavlja finansijski izveštaj o troškovima za januar - decembar 2024. godine.

**Enver Gashi** – izveštaj je dostavljen na vreme i mi kao grupa nemamo primedbe.

**Sami Ahmeti** – U stvari, izveštaj treba da nam dođe na vreme i da ga razmotre odbornici Skupštine opštine, jer mi se čini da se nastavlja praksa da skoro glavno mesto zauzimaju plate i dnevnice, dok kapitalne investicije preko 80% isle samo na jednom projektu koji je do sada izazvao više haosa i razaranja puteva i još mnogo toga, nego što se vidi kraj ili nešto nabolje za građanr. Ono što sam želeo da istaknem je da već treću godinu zaredom, iako je to simboličan iznos, i dalje ne dobijamo izveštaj u vezi sa troškovima Skupštine opštine. Znamo da ovde ima opštinskih odbornika koji svakog meseca dobijaju dopune telefona nekada za sebe, a nekad za članove svojih porodica, a mi ne dobijamo dopune telefona. Pored onih ručkova i večera na koje nikada ne dolazimo, više se održavaju sa izvršnom vlasti nego sa odbornicima Skupštine opštine, kao i ekskurzije. Iz tog razloga vas obaveštavam da ću na kraju ove sednice podneti zvaničan zahtev za pristup javnim dokumentima, kako nam zakon dozvoljava, a svaki trošak koji je nastao znam da su od 9.000 evra, ali kada se zloupotrebljava ista je tendencija. Dakle, uputiću zvaničan zahtev i sačekaću odgovor, naprotiv trazicu preduzimanju drugih mera.

**Presedavajuća** – Što se tiče troškova, finansijskog izveštaja Skupštine opštine za ručak i večere, svi su pozvani na otvoren i transparentan način i sve se prenosi uživo, kao što je to uvek bilo od osnivanja ove Skupštine, verovatno od poslerata. Što se tiče telefonskih dopuna, nije prvi put da se od svih članova Skupštine traži broj telefona, a svakom je poslata elektronska dopuna, a što se tiče poseta u inostranstvu, postoji plan rada gde ste bili i vi član ove Komisije koju je formirala ova Skupština i postoje potpisi. Međutim, vaše je pravo što zelie da tražite uvid najavnim dokumentima.

**Ajet Berisha** – Imam 2 pitanja, izveštaj o prihodima je prikazan januar-septembar, to je 90,42% ostvarenih prihoda i moje pitanje je da li je do septembra ili do decembra.

**Potpredsednik** – Odgovara da izvestaj predstavlja rashod do decembra.

**Ajet Berisha** – Imam pitanje i za kapitalne investicije, izgradnja parkinga u ulici „Adema Jašarija“ je 50.000 evra, realizacija je 100% gde je ovaj projekat realizovan jer sam živim u ovoj ulici i ne znam gde se nalazi.

**Potpredsednik** – Odgovara da je projekat planiran prošle godine, kod stare škole, ali znate da je prošle godine od izvršioca oduzeto preko milion i 600 hiljada evra, pa to je izašlo kao trošak, inače nije započet.

**Ajet Berisha** – Ne bi trebalo da se pojavi kao završen projekat jer izlazi neka vrsta prevare i dobro je ispraviti.

#### **Tačka 5. dnevnog reda**

**Presedavajuća** – Iznela je zahtev Ministarstva finansija da se završi izmena Odluke o dodeli budžetskih sredstava u iznosu od 2.000 evra za Opštinsku izbornu komisiju u vezi sa pripremama za opšte parlamentarne izbore koje će se održati 09.02.2025.

Poštovani odbornici, imamo sporazum o saradnji između Centralne izborne komisije i opštine Obilić, koji će biti priložen uz odluku, a od Direkcije za finansije imamo potprogram da će se sredstva oduzeti iz linije robe i usluga.



Odbornici Skupštine opštine sa 18 glasova za i 2 uzdržana doneli odluku o izmeni odluke br. 01-060-01-36671-24 od 29.11.2024. godine za dodelu budžetskih sredstava u iznosu od 2.000 evra, Opštinskoj izbornoj komisiji, u vezi sa pripremama za opšte parlamentarne izbore koji će se održati 09.02.2025.

**Presedavajuća** – Podnela zahtev VIZ, preporuke KPF-a, od 20.12.2024. godine, gde se preporučuje Direkciji za finansije za mogućnost prenosa finansijske imovine od Kosovske energetske korporacije (KEK), nakon premeštanja džamije u selo Sibovac.

**Enver Gashi** –potpuno ste razjasnili pitanje. Tu džamiju je izgradila zajednica i zemljište na kojem se džamija nalazi pripada opštini, dok se Islamska zajednica takođe uključila u ulaganje džamije i traži da ta sredstva za izgradnju idu BIK-u. Mi smo za to da ta sredstva idu kako treba, zašto da dođu kod nas i ponovo na drugog.

**Sami Ahmeti** – Definitivno se slažemo da oni dobiju ta sredstva, ali mi se čini malo nenormalnim jer dajemo nove muke onima koji su već sklopili ugovor sa KEK-om. U svakom slučaju, šta god je u njihovom interesu, ako je ovo najlakši oblik i najkraći put, slažemo se, iako mislim da je poželjno da se ta sredstva podele od ukupnog iznosa Opštine. U svakom slučaju, ako se slažu i njima odgovara, slažemo se, nije bitno od koga se prenose jer sredstva pripadaju državi.

**Ajet Berisha**– Prvo, želeo bih da pojasnim vi ste rekli da je to u okviru preporuka i da postoji 5 tačaka u preporukama, što ja uopšte ne vidim, znači da nije u okviru preporuka ovog meseca.

**Presedavajuća** – Ona pojašnjava da je to tačka 6 preporuke koju smo doneli 20.12.2024 i da nije deo ovog meseca.

**Ajet Berisha** –kako je najbolje pravno i najpraktičnije, neka se realizuje, da nema odlaganja i nemam drugih primedbi.

**Shaip Paloja**– Koliko sam shvatio, ako donesemo takvo rešenje, mi smo u suprotnosti sa zakonom, jer se priča da je na opštinskom imanju urađena gradnja bez građevinske dozvole. Ne znam ni čime, ni od kada su tu džamiju podigli na opštinskom imanju i da li imaju neku odluku Opštine. E sad, ne znam kako može da se isplati imovina kada je vlasnik Opština.

**Potpredsednik** – Što se tiče izdavanja dozvole, ovo je izgrađeno 2000. godine i imovina se ne plaća, zemljište se nadoknađuje opštini,. Procenu koju je napravila Komisija za stambene, verske i druge objekte uradio je KEK, a tačna procena koliko će se plaćati kao objekat je posebno pitanje. Najlakši i najbolji način je da nadoknada ide direktno u Islamsku zajednicu, a što se tiče imovine, imovina ona se nadoknađuje onoliko koliko se plaća po Zakonu o eksproprijaciji i za opštinu.

**Arben Berisha** – Tačno je ono što je potpredsednik rekao i procena je napravljena posebno za objekat i za parcelu. Parcela je izgrađena u ranim godinama, negde 70-ih godina, tako da objekat pripada zajednici a sada traže ta sredstva za izgradnju džamije u Novo Hade. Imamo regulacioni plan i to je predviđeno i zonskom kartom, tako da ga treba preneti na izgradnju džamije zbog zajednice. To znači da nema nejasnoća i da je sve razjašnjeno.

**Shaip Paloja** – Imam pitanje za direktora, ako je privatnik gradio na opštinskoj imovini i KEK konfiskuje tu imovinu ili je u pitanju neki drugi interes, da li se plaća deo materijala koji je na opštinskoj imovini, kada je u pitanju privatno lice.

**Potpredsednik** - Imali smo takav slučaj, jer je proces eksproprijacije počeo 2004. godine i svesni smo toga. Isto tako, bilo je slučajeva u Hade i Šipitulu kada su imali imanja, ili kuće izgrađene 60-ih ili 70-ih godina, ali nije plaćena opštinsko zemljište, već se plaćala samo zgrada kao zgrada.

Nakon rasprave, odbornici Skupštine opštine sa 20 glasova usvojili su Odluku o prenosu finansijskih sredstava, sa Kosovske energetske korporacije (KEK), na Versku Islamsku zajednicu, nakon izmeštanja Džamije u selo Sibovac.

**Presedavajuća** –Da znate i da sam videla mejlove u koje ste bili uključeni kao članovi Skupštine, gde je juče stigla peticija bez protokola samo sa kopijom lične karte i brojem telefona. Grupa građana organizuje ovu peticiju za regulisanje prevoz putnika autobusom u opštini Obilić i uzeli su kao model kao opštine Priština Pre nego što počnemo sa debatom, predlažem da se ova peticija prvo razmotri od nadležne direkcije.



**Enver Gashi** – Hteo sam i da kažem da ovu peticiju treba poslati DJS, da je pažljivo ispita Direkcija za finansije i da se sagledaju mogućnosti ako postoje mogućnosti, zašto da se ne iznese u Skupštinu i Skupština da svoj doprinos.

**Sami Ahmeti** –da kažem da je zahtev upućen sa jedne strane, ali mi nemamo drugu stranu koja nam daje uputstva odakle, kada i kako se sklapa ovaj sporazum. U svakom slučaju, smatram da je veoma dobro pitanje za građane ako se radi po zahtevu koji je podnet. U potpunosti se slažemo da ovaj zahtev treba sprovesti, ali ne i da se krše zakonske odredbe jer se sada provlače kroz Ministarstvo i odugovlače posao. Prvo neka nadležna direkcija dođe sa preporukom sa svim merama, pa i sa budžetskim, onda se normalno slažemo da ispunimo ovaj zahtev iznet u ovoj peticiji.

**Ajet Berisha** – time se bavio i KPF i nismo dobili odgovor, tako da ne znam o čemu se radi u ovoj peticiji.

**Presedavajuća** - Zahtev koji je obrađen u Komitetu za politiku i finansije nema veze sa peticijom. Peticija je stigla juče u mejlima svih članova Skupštine, imate je u mejlu i to je dokaz. Ova peticija je stigla od Diellze Aliu u službenim mejlovima.

**Ajet Berisha**– Što se tiče ove peticije, ja iskreno ništa ne razumem, sav ovaj rad, sve ove potpise i šta su tražili, ne znam, niti postoji objašnjenje iz Prištine ko je to uradio. Pa šta je svrha peticije, da se reguliše prevoz, da se u dobru i u zlu reguliše prevoz u nekom obliku.

**Naim Miftari** – Direkcija javnih službi je prihvatila zahtev i preporuke Komiteta za politiku i finansije. Na ovaj zahtev se ne može dati ad hoc odgovor, na licu mesta jer je potrebna studija i naša direkcija će formirati komisiju, koja će analizirati stanje na terenu za sve transportne operatere, koji pružaju usluge na teritoriji opštine Obilić. a na kraju rada ću sastaviti pismeni izveštaj. Možemo da uzmemo opštinu Priština kao modalitet, ali da vidimo šta možemo bolje. Peticija je podrška zahtevu građana.

**Ajet Berisha** – ne razumemo se, pa je dobro da ovi podnosioci predstavke razjasne šta hoće, šta traže.

**Presedavajuća** – Peticija direkcijama nije stigla, a zahtev koji je razmotren u Komitetu za politiku i finansije je nešto drugo, preporučljivo je da dođete sa odgovorom u Skupštinu, bilo u ovom ili narednom sastanku. Peticija je izneta u skladu sa Statutom opštine Obilić, član 33, Skupština opštine neće imati predstavke u vezi sa pitanjima van nadležnosti i ovlašćenja opštine. Ovo je u nadležnosti Opštine, svaka peticija mora da sadrži ime, prezime i adresu organizatora i lica koje potpisuju predmet peticije na svakoj stranici peticije.. Ne poznajem ovu devojkicu koja je to slala na svaki mejl članova Skupštine i ja sam vam to predočila Iako nije evidentirano, mislim da je dobro da to preporučite nadležnoj Upravi i zvanično dolazi kako treba peticija sa brojem protokola.

**Fidan Ahmeti** – Koliko sam razumeo, kako Priština radi sa gradskim saobraćajem, traže da im se plaća po kilometrima, na primer u nekim selima koja idu jednom dnevno, da nemaju problema, imaju li putnike ili ne treba da ih subvencionišu opština, prema kilometrima. To je razlog, ali moramo da vidimo da li imamo mogućnosti da ih subvencionišemo jer je vrednost dovoljno velika da je to možda nemoguće, a možda i moguće, ali neka nadležna direkcija napravi kompletan plan i da vidimo da li imamo mogućnosti, ili ne

**Presedavajuća** – Moramo preporučiti DJS, da kontaktiraju ljude da peticija mora da ima broj, objašnjenje na šta se zasniva, a postoji rok od 3 meseca da se ova peticija razmotri i završi u Skupštini opštine.

Odbornici Skupštine opštine jednoglasno su se složili da se peticija preporučuje DJS, te da se sastavi na razmatranje na sednici Skupštine opštine.

#### **Tačka 6. dnevnog reda**

**Presedavajuća** – Dobili smo odgovor od Uprave za obrazovanje na pitanje gospodina Samija Ahmetija za početak školske 2024-2025 godine, DO je obezbedila da je sistem grejanja u ispravnom stanju. Time se realizuju neophodni uslovi za nastavu, tako da je drugo polugodište počelo po godišnjem planu i bez prekida nastave, kao što ste i sami svesni, na osnovu kontinuiteta vaše dece u procesu nastave poteškoće u tenderskim ugovorima i problemima i u organima za razmatranje javnih nabavki, mi kao DO u letnjim mesecima smo tenderisali projekte snabdevanja drvetom koje smo ostvarili kroz rezerve i iz prethodne godine i snabdevanje ugljem iz KEK-a. Krajem godine, DO je uputila odgovarajuća pisma korporaciji na osnovu memoranduma o razumevanju između predsednika i KEK-a, da koordinira radove tako da stanje



grejanja bude na pravom nivou i da imate dokaze za svaku školu. Sada možete imati pristup svim obrazovnim objektima i potvrditi da je grejanje na pravom nivou i da ispunjava uslove zimske sezone. 18. i 19. januara smo snabdevali sve obrazovne objekte drvima prema ugovoru kojeg smo već potpisali. Dakle, niti smo imali prekida, niti će biti mesta za brigu jer se sve dobro vodi.

**Sami Ahmeti** – Zapravo, odgovor smo dobili na kraju, jer je potrebno od početka reći da imamo problem sa OSHP, obavili smo procedure ali nismo uspeli da ih obezbedimo. Međutim, bilo je prepreka i dobro je da je to popravljeno, nadamo se da će tako biti i u narednom periodu.

**Ajet Berisha** – Ne slažem se samo sa jednim elementom u odgovoru. Ne znam za sve škole, ali znam da je srednja škola imala probleme, a ovde se kaže da nemaju probleme. Istina je da je bilo problema u školi "Hasan Priština" i nije sramota prihvatiti realnost, sramota je izbegavati i lažno predstaviti a imamo i profesore koji su tu. Nije sramota reći da smo imali probleme sa zgradom, ili smo imali poteskoce sa OSHP, to znači prijaviti situaciju kakva je i zašto moramo da je izbegavamo kada svako od nas ima decu. Realnost je da je bilo problema sa grejanjem, ali to je prošlo, jako je dobro i ne usudujemo se da nam se skoro svake godine u školama ovaj problem predstavlja, posebno u srednjoj, dok one koje imaju grejanje na pelet rade bolje. Mislim da treba doneti neke odluke da ove kotlove zamenimo na pelet, ili na struju jer ima problema, možda ne krivicom Opštine, ali realnost je da su deca održali pola sata naastavni čas, Izveštavanje treba da bude korektno, što nam pomaže da rešimo probleme.

**Labinot Mirena** – Svi ovi kvarovi koji su u školama je adresa Vlade Kosova, jer da su oni subvencionisali centralno grejanje ne bi trebalo da uključujemo kotle, niti bilo šta, ostavili smo centralno grejanje i računi za struju ne bi bili tako skupi. Ipak, verujemo i nadamo se da ovo pitanje neće biti problem posle 9. februara.

**Sami Ahmeti** – 15. januara 2025. godine, Vlada Republike Kosovo, odnosno Policija Republike Kosovo, izvršila je pretres i zatvorila oko 30 objekata paralelnih srpskih struktura kojima je upravljala Srpska lista. Među ovim objektima je i objekat paralelne Opštine u Plemetetinu i ono što želim da istaknem je da je predstavnik ove paralelne opštine bio gospodin Slaviša Jakovljević, koga je izabrala ova Skupština i Predsednik opštine. Ovo je za nas skandalozno jer ova osoba radi za i sa paralelnim strukturama koje koordinira Srpska lista, odnosno iz Srbije i Rusije, ujedno je i zamenik predsednika naše opštine koji se plaća novcem poreskih obveznika Republike Kosova. Pored toga, gospodin Slaviša Jakovljević je i direktor nelegalnog preduzeća „Čišćenje“ poznate kao javna komunalna služba. Ovo preduzeće se bavi čišćenjem srpskih sela, a plate primaju od Vlade Srbije. U okviru ovog preduzeća, sumnja se i za nezakonite radnje. Na osnovu onoga što sam gore naveo, tražim da se ovo lice razreši sa dužnosti danas na ovoj sednici jer lice koje prima platu od Republike Kosovo i kojim komanduje Srbija, ne može stoga molim predsedavajuću da ga stavi na glasanje za razresenje, a ako ne, onda imamo puno razloga da mislimo da nešto nije u redu, da li smo na pravoj strani ili sa Srbijom.

**Presedavajuća** – Poštovani gospodine Ahmeti, ne možemo imenovati niti smeniti nikoga, jer ste i sami bili protiv u mnogim ovakvim slučajevima, ali bez dokaza ne možemo ništa. Ja bi bila za a verujem i svi vi ako imate dokaze i donesete na sledećem sastanak i vidime kako ćemo. Mislim da ova stvar nije samo za njega, već i za mene ovde konkretno, ako neko kaže da predsedavajuća radi nezakonite radnje, ne može se nešto preduzeti na licu mesta bez dokaza. Dakle, donesi dokaze i radicemo po zakonu.

**Ajet Berisha** – Mislim da gospodin Sami, jedino što treba uraditi jeste da nam ove dokaze šalje mejlom, ili da ih deponuje kod vas, inače on ima informaciju, jer tamo radi.

To znači da ona raspolaže državnim informacijama da su radnju uradile državne institucije i ako je to tačno, da zatraži ove dokaze kako bi se na sledećem sastanku pokrenuo postupak.

**Presedavajuća** – Ovi podaci su trebali biti upućeni meni kao što je peticija svima stigla na mejlu i ti podaci su mogli doći do nas, kako bi mogli razmotriti jer neću raditi protiv zakona.

**Sami Ahmeti** – Ovi podaci su samo 50% onoga što mogu javno da govorim i to su ne samo tačni, već 500% tačni i ovo su znali i građani koji su nam stalno govorili da dobijaju neke potvrde od gospodina



Slaviše, u paralelnom objekt u Plemetinu. Ali ovu stvar ste znali i vi, ali je nekako strašno kao da neko saraduje sa njim.

**Presedavajuća** – Gospodine Ahmeti, ne bi volela da nas uključite, jer nemamo te podatke. U svakom slučaju, mi nemamo nikakve dokaze ni od vas ni od bilo koga drugog i mogu da govorim sa punom odgovornošću pre svega za sebe.

**Sami Ahmeti** –želim da ispravim sebe, pod rečju vi mislim na izvršnu vlast jer mi kao odbornici u Skupštini opštine radimo ono što nam se servira, ali ovo što govorim je nešto sigurno. Ja ću vam priziti sve informacije i molim vas da napišete 2 reda zahteva za Kosovsku policiju i vidite šta ce vam vam pisati.

**Potpredsednik** - Ne može se adresirati izvršnoj vlasti jer ja lično nemam nikakvu informaciju ako postoji sudska odluka da je gospodin Ibush Mjekici ili ko god da je to uradio, cnda se donosi odluka, inače ne mogu da prihvatim ove pausalne reci. Ne možete da se obraćate u ime izvršne vlasti, jer ja ne saradujem ni sa kim niti ostali, saradujem samo u okviru zakona, zato je ovaj vaš govor veoma težak. S druge strane, za ručak i večeru nismo platili ni 5.000 evra ni 350.000 evra, ručak i večera su plaćeni onoliko koliko ste i vi učestvovali na ekskurzijama koje smo održali za obuku. Zato vas molim da povučete reč Izvršna vlast, jer ne saradujemo sa paralelnim organima bilo koje institucije.

**Sami Ahmeti** – Prvo, što se tiče ručkova i večera, dobro je da pričate kada je ovo pitanje na dnevnom redu, možda ste u pijanom stanju, je nisam pomenuo 350.000 evra.

Sastanak je završen u 11:57' časova

Stručno lice za posao SO

  
Azize Zeneli



Presedavajuća Skupštine opštine

  
Vlora Mjekiqi Kabashi